



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 05/L -153**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE QEVERISË SË HUNGARISË PËR  
THEMELIMIN E PROGRAMIT KORNIZË PËR BASHKËPUNIM  
FINANCIAR**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË  
SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE QEVERISË SË HUNGARISË  
PËR THEMELIMIN E PROGRAMIT KORNIZË PËR BASHKËPUNIM  
FINANCIAR**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim të ratifikojë Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Hungarisë për themelimin e programit kornizë për bashkëpunim financiar.

**Neni 2**  
**Ratifikimi i Marrëveshjes**

Ratifikohet Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Hungarisë për themelimin e programit kornizë për bashkëpunim financiar, e lidhur më 14.12.2016, në Prishtinë.

**Neni 3**  
**Dokumentet e bashkëngjitura**

Në Shtojcën e këtij ligji është e bashkëngjitur Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Hungarisë për themelimin e programit kornizë për bashkëpunim financiar.

**Neni 4**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L -153**  
**10 mars 2017**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

\_\_\_\_\_  
**Kadri VESELI**

## **MARRËVESHJE**

### **NDËRMJET**

## **QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

### **DHE**

## **QEVERISË SË HUNGARISË**

### **PËR THEMELIMIN E PROGRAMIT KORNIZË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR**

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Hungarisë (më tutje: Palët Kontraktuese) bien dakord për zgjatjen reciprokisht të dobishme të marrëdhënieve ekonomike dhe promovimin e zhvillimit të bashkëpunimit si në vijim:

#### ***Neni 1***

#### **Përkufizimet**

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje:

*a) kredia e dedikuar për ndihmë:* krediti i eksportit dedikuar me prokurimin e mallrave dhe/ose shërbimeve me origjinë nga Hungaria dhe e mbështetur zyrtarisht përmes përkrahjes së normave të interesit dhe të sigurimit me një nivel koncensionaliteti jo më pak se përqindja përkatëse e përcaktuar në dispozitat e Marrëveshjes OECD për "nivele minimale të koncensionalitetit";

*b) kreditë përziera :* pakot e ndërdedikuara të financimit të kredive koncesionare të përziera me grante. Niveli i përgjithshëm i koncensionalitetit të një pakoje të përcaktuar në rregullat e OECD-së është llogaritur mbi bazën e subvencionit të interesit dhe pjesën e grantit, ky i fundit mund të përfshijë, por nuk e kalon shumën e primit të rrezikut;

*c) niveli i koncensionalitetit:* dallimi në mes vlerës nominale të kredisë së dedikuar për ndihmë dhe i vlerës aktuale të zbritur nga shërbimi i borxhit për t'u paguar në të ardhmen nga huamarrësit, e shprehur si një përqindje e vlerës nominale të kredisë së dedikuar për ndihmë;

*d) vlera nominale e ndihmës së dedikuar:* vlera totale e projektit të financuar në kuadër të kredisë së dedikuar për ndihmë të dedikuar së bashku me primin e rrezikut për shlyerjen e kredisë pa përfshirë interesat;

*e) Elementi i grantit:* pjesa e vlerës nominale të kapitalit të kredisë së dedikuar për ndihmë, jo-e pagueshme nga Huamarrësi;

*f) Marrëveshja e OECD:* Marrëveshja e OECD mbi kredinë e eksportit të përkrahur zyrtarisht, që hyn në fuqi në ditën e kontraktimit;

g) *Pika e fillimit e kredisë*: të përcaktohet në përputhje me listën e përkufizimeve të përcaktuara në pikën m) të Aneksit XIV të marrëveshjes së OECD;

h) *NZD: Norma e Zbritjes së Diferencuar* përdoret për llogaritjen e nivelit të koncensionalitetit të ndihmës së dedikuar në një valutë të caktuar, sic përcaktohet në dispozitat e Marrëveshjes së OECD për "llogaritjen e nivelit të Koncensionalitetit të ndihmës së dedikuar";

i) *AZhZ: Asistenca Zhvillimore Zyrtare*.

## *Neni 2*

### **Krijimi i programit kornizë për bashkëpunimin financiar**

Qeveria e Hungarisë, në pajtueshmëri me politikën e saj ndërkombëtare të zhvillimit dhe bashkëpunimit, ofron një mbështetje të pakthyeshme zyrtare përmes mbështetjes së normës së interesit dhe elementit të grantit, për kreditë e dedikuara për ndihmë (më tutje: kreditë e linjës të dedikuara për ndihmë) disbursuar nga Bank Hungareze Eksport-Import Pte. Ltd. (më tutje: Eximbank) me kushtet e kornizës të përcaktuara në këtë Marrëveshje, në dispozicion për financimin e sektorëve me prioritet e lartë të zhvillimit të Republikës së Kosovës, të shprehur në Shtojcën I.

Qeveria e Republikës së Kosovës pranon linjën e kredisë së dedikuar për ndihmë dhe, duke vepruar në pajtueshmëri me sistemin e vet ligjor dhe detyrimet ndërkombëtare, mbështet realizimin e programit aktual kornizë të kredisë së dedikuar për ndihmë duke pranuar detyrimet e pagesës së kredisë së shpenzuar dhe ngarkesat/pagesat shtesë të saj (nëse ka). Për shmangien e çdo dyshimi, në rast se sipas marrëveshjeve të veçanta të kredive, Ministria e Financave e Republikës së Kosovës - si organizatë e autorizuar e Qeverisë së saj - do të veprojë si huamarrës, veprimet nga ana e Ministrisë së Financave do të konsiderohet të jetë sovrane sipas kësaj Marrëveshjeje.

Palët Kontraktuese shprehin vullnetin e tyre lidhur me pjesëmarrësit e transaksioneve të kredisë që i përkasin linjës aktuale të kredisë së dedikuar për ndihmë dhe do të konfirmojnë përmes deklaratave se në pajtim me dispozitat e deklaratës së veprimit të OECD-së për "Mitoja dhe kreditë e eksportit të mbështetura zyrtarisht" ata nuk kanë marrin pjesë në asnjë ryshfet/mito në lidhje me transaksionet dhe ata nuk janë në dijeni të ndonjë korrupsioni..

## *Neni 3*

### **Shuma e linjës së kredisë së dedikuar për ndihmë dhe kushtet e saj financiare**

Vlera e përgjithshme e projekteve të financuara sipas linjës së kredisë së dedikuar për ndihmë nuk duhet të kalojë gjashtëdhjetë e dy (62) milion euro. Zotimet konkrete rrjedhin në bazë të marrëveshjeve të veçanta të kredisë së dedikuar ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe Eximbank siç përcaktohet në nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje.

Niveli i koncesionalitetit të kredive të pagueshëme sipas linjës së kredisë së dedikuar për ndihmë do të arrijë të paktën 35 për qind në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes për OECD për "nivele minimale të koncesionalitetit".

Afati i kredive të disbursuara sipas linjës së kredisë së dedikuar për ndihmë nuk mund të kalojë tetëmbëdhjetë vjet e gjysmë (18.5), i cili përfshin një vit e gjysmë (1.5) periudhë mospagimi dhe shtatëmbëdhjetë (17) vjet periudhë shlyerje. Shlyerja e parë bëhet 24 muaj nga përfundimi i çdo projekti. Norma e interesit është zero (0.00%) përqind në vit.

Premiumi i sigurimit, për çdo marrëveshje individuale kredie që rrjedh nga kjo Marrëveshje Kornizë, do të mbulohet nga Qeveria Hungareze.

Periudha e disbursimit të kredive sipas linjës së kredisë së dedikuar për ndihmë do të përcaktohet në marrëveshjen e kredisë individuale në varësi të projekteve të veçanta. Përveç nëse ndryshe dakordohen palët reciprokisht në çdo kontratë individuale, periudha disbursimit të kredive individuale nuk duhet të kalojë tre (3) vjet.

Në lidhje me kreditë disbursuara sipas linjës së kredisë së dedikuar për ndihmë, primet e rrezikut të parashikuara në marrëveshjet e veçanta të kredisë do të kalkulojnë në përputhje me Marrëveshjen e OECD, dhe do të mbështeten zyrtarisht dhe të përfshihen si pjesë e grantit të pakos së financimit të dedikuar.

#### *Neni 4*

### **Shfrytëzimi i linjës së kredisë së dedikuar për ndihmë**

Linja e kredisë së dedikuar për ndihmë mund të shfrytëzohet për realizimin e projekteve në sektore që nuk kundërshtohen prej nënshkruesve të Marrëveshjes së OECD gjatë procedurës në përputhje me rregullat e pranimit të Marrëveshjes së OECD dhe respektivisht procedurën e konsultimit.

Palët Kontraktuese bien dakord se Qeveria e Republikës së Kosovës do të zbatojë linjën e kredisë së dedikuar për ndihmë për sektorë të specifikuar në Shtojcën I që formojnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Projektet e përzgjedhura do të realizohen nga eksportuesit hungareze të cilat kompani duhet të jenë të regjistruara në Hungari. Eksportet e financuara të realizuara sipas linjës së kredisë së dedikuar për ndihmë mund të përfshijnë përmbajtjen e huaj në rastet nëse të paktën 50 për qind e eksportit të realizuar nga kompanitë e regjistruara në Hungari cilësohet si me origjinë hungareze të kryera në territorin e Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës apo organizata e caktuar nga ajo zgjedh kompanitë e regjistruara në Hungari (më tutje: eksportuesi) për realizimin e projekteve në sektorë të përcaktuara në Shtojcë, në përputhje me legjislacionin e saj, duke vepruar në pajtim me parimet e përgjithshme të pranuar dhe praktikat e mira të prokurimit, si dhe i jep Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Tregtisë informacione në lidhje me vendimet e saj. Për më tepër, llojet e mëposhtme të prokurimit për projektet që do të financohen sipas kësaj Marrëveshjeje mund të jenë:

- a. Ofertimi i kufizuar (i kufizuar për kompanitë e pranueshme/eksportuesit sipas kësaj Marrëveshje Kornizë)
- b. Kontraktimi i drejtpërdrejtë

## *Neni 5*

### **Procedura e Miratimit**

Ministria e Financave e Republikës së Kosovës do të dorëzojë propozimet e projekteve për aprovim të financimit nga Ministria Hungareze e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë. Projektet e propozuara duhet të rrjedhin nga sektorët e renditur në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Palët kontraktuese, pas miratimit të propozimit të projektit që do të financohet në bazë të linjës së kredisë për këtë Marrëveshje, do të respektojnë procedurën e mëposhtme:

- a) Eksportuesi dhe blerësi/importuesi elaborojnë kontratën e eksportit për realizimin e projektit.
- b) Ministria e Financave e Republikës së Kosovës miraton kontratën e eksportit të përfunduar dhe dërgon një njoftim me shkrim në lidhje me këtë tek Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë dhe Eximbank Hungareze.
- c) Eximbank konfirmon me shkrim për fillimin e negociatave për marrëveshjen e kredisë individuale në bazë të kontratës së eksportit të miratuar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës.

## *Neni 6*

### **Disbursimi i kredisë së dedikuar për ndihmë**

Kushtet e hollësishme të disbursimit të kredisë së dedikuar për ndihmë të dhënë për financimin e projekteve për sektorët e pranuar nga Palët Kontraktuese me këtë Marrëveshje Kornizë duhet të përcaktohen me marrëveshje individuale kreditit që janë subjekt i negociatave midis huamarrësit të autorizuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 7 nga njëra anë dhe Eximbank si huadhënës në anën tjetër.

Eximbank, për shkak të burimeve të veta, huazon kredi të dedikuar për ndihmë, deri në shumën e linjës së kredisë të rënë dakord në këtë Marrëveshje, në formën e kredive të përziera për huamarrësin e autorizuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për realizimin e projekteve në sektorët e pranuar. Masa e financimit është 100 për qind e vlerës së projektit dhe shumën e elementit të grantit.

Rreziqet komerciale dhe politike të kredisë së dedikuar për ndihmë do të sigurohen nga Sigurimi Hungarez për Kredi Eksporti Pte. Ltd. (më tej: MEHIB).

## *Neni 7*

### **Parakushtet e përgjithshme të marrëveshjeve individuale të kredisë**

Sipas detyrimeve relevante ndërkombëtare, kreditë individuale të dedikuara për ndihmë për financimin e projektit të veçantë do të njoftohen dhe pranohen nga OECD dhe BE-ja. Pas ekzekutimit të suksesshëm të kësaj procedure, njoftimi me shkrim i dërgohet respektivisht blerësit, eksportuesit, dhe Palëve Kontraktuese.

Huamarrësi në bazë të marrëveshjeve të veçanta të kredisë do të jetë Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, si përfaqësues i autorizuar i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në marrëveshjet e veçanta të kredive, Ministria e Financave e Republikës së Kosovës do të marrë përsipër shlyerjen e kredisë, pagimin e interesave dhe pagesat shtesë (nëse ka), bazuar në linjën aktuale të kredisë së dedikuar për ndihmë në rastin e sektorëve të përcaktuara në Shtojcën I.

Republika e Kosovës duhet të lë mënjanë shumën e detyrimeve të pagesave të saja për vitin aktual në buxhetin e saj shtetëror.

Eximbank dhe MEHIB do të lidhin një kontratë të sigurimit të kreditit e cila i plotëson kushtet e përcaktuara nga ligji hungarez në fuqi.

## *Neni 8*

### **Tatimet, tarifat**

Palët Kontraktuese janë të detyruar të paguajnë tatimet, tarifat dhe pagesat e tjera publike që lindin në bazë të ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje në vendin e tyre. Këto kosto nuk mund të paguhen nga kreditë individuale të dedikuara për ndihmë dhe nuk mund të ndahen. Kostot që shkaktohen gjatë marrëveshjes individuale të kredisë do të paguhen nga palët e marrëveshjes së kredisë në vendin e tyre dhe ata nuk mund të ngarkohen për kreditë individuale të dedikuara për ndihmë.

Gjatë rimbursimit të kredisë dhe pagesës së interesit (nëse ka) shumat e pagueshme nuk mund të ulen nga tatimet e vjelura nga Republika e Kosovës ose shumave të tjera që lindin si rezultat i detyrimeve të tjera të pagueshme.

## *Neni 9*

### **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Palët Kontraktuese do të zgjidhin çdo mosmarrëveshje për këtë Marrëveshjeje me negociata të drejtpërdrejta.

## *Neni 10*

## Ligji i Zbatueshëm dhe Arbitrazhi

Marrëveshja individual e kredisë do të qeveriset nga ligjet e Hungarisë.

Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga ose në lidhje me marrëveshjen e kredisë individuale do të zgjidhen së pari nga negociatat miqësore në mirëbesim. Në rast se mosmarrëveshjet në fjalë nuk zgjidhen brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike, mosmarrëveshjet në fjalë do të zgjidhen përfundimisht në bazë të Rregullores së Pajtimit dhe Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) në Paris nga tre (3) persona të arbitrazhit. Arbitrazhi do të zhvillohet në gjuhën angleze. Vendi i arbitrazhit do të jetë Parisi, Franca.

### *Neni 11*

#### **Dispozitat Përfundimtare**

- a) Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për katër vjet nga data e hyrjes në fuqi dhe do të rinovohet automatikisht për një periudhë prej një (01) viti, përveç nëse një Palë njofton tjetrën për vendimin e saj për të ndërprerë atë, me anë të një njoftimi me shkrim së paku tre (03) muaj para skadimit.
- b) Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, edhe pas skadimit të tyre, do të jenë të aplikueshme për projektet të cilat janë të financuara në bazë të marrëveshjes individuale të kredisë të lidhura në bazë të kësaj Marrëveshjeje
- c) Kjo marrëveshje hyn në fuqi në tridhjetën (30) ditë pas marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike me të cilët palët kanë konfirmuar se procedurat e tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje kanë përfunduar.
- d) Kjo Marrëveshje mund të anulohet me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike pa shpjegim nga secila Palë Kontraktuese. Në këtë rast, Marrëveshja do të anulohet në 30 (tridhjetën) ditë nga marrja e njoftimit për anulim nga Pala tjetër Kontraktuese. Nëse kjo marrëveshje anulohet nga cila do palë, kontratat e nënshkruara në mënyrë individuale do të mbeten në fuqi deri në përfundim dhe nuk do të ndikohen nga një anulim i tillë.
- e) Palët Kontraktuese mund të ndryshojnë apo plotësojnë këtë Marrëveshje sipas vullnetit të tyre të përbashkët dhe marrëveshjes. Pas përfundimit të procedurave të brendshme për ndryshime dhe plotësime, këto ndryshime dhe plotësime do të hyjnë në fuqi në përputhje me pikën c) të këtij neni.

E nënshkruar në            më datë    në gjuhën angleze, në tri origjinale.

.....  
në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës

.....  
në emër të Qeverisë së Hungarisë



**SHTOJCA**

**PËR LISTËN E FUSHAVE TË PROPOZUARA PËR REALIZIMIN NË BAZË TË  
MARRËVESHJES MBI PROGRAMIN KORNIZË PËR BASHKËPUNIM  
FINANCIAR NDËRMJET HUNGARISË DHE REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

- Ujë dhe ujëra të zeza
- Infrastrukturë